

URDHËR
Nr.301, datë 1.4.2008

PËR LICENCIMIN E AGJENCISË SË ADMINISTRIMIT KOLEKTIV TË SË DREJTËS SË
AUTORIT NË FUSHËN E KINEMATOGRAFISË DHE TË VEPRAVE TË TJERA
AUDIOVIZUALE “FMAA”

Duke marrë parasysh dokumentet e mëposhtme, bashkëlidhur:

1. kërkesën dhe dosjen me dokumentacionin e agjencisë “FMAA”;

2. propozimin e Zyrës Shqiptare për të Drejtën e Autorit, nr.163, prot., datë 7.3.2008, për licencimin e kësaj agjencie në fushën e kinematografisë dhe të veprave të tjera të audiovizualit, për të ushtruar dhe mbrojtur të drejtat e autorëve krijues, regjisorë dhe skenaristë;

3. shkresën nr.1775/1, datë 17.3.2008 të Drejtorisë së Arteve dhe Letrave, mbi ligjshmërinë e kërkesës dhe dosjes,

konstatoj se, në përmbushje të detyrimeve ligjore që burojnë nga ligji nr.9380, datë 28.4.2005 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të”, është kompetencë e ministrit miratimi i dhënies së licencës së kësaj agjencie në fushën e kinematografisë.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës, të nenit 124, pika 1 të Kodit të Procedurave Administrative dhe të neneve 108, pika 1, dhe 109, pika 2 dhe 3 të ligjit nr.9380, datë 28.4.2005 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të”,

URDHËROJ:

1. Licencimin e Agjencisë së Administrimit Kolektiv të së Drejtës së Autorit “FMAA” në fushën e kinematografisë dhe të veprave të tjera të audiovizualit, për të ushtruar dhe mbrojtur të drejtat e autorëve krijues, regjisorë dhe skenaristë.

2. Muzika e kësaj fushe të ushtrohet dhe të mbrohet nga “Albautor”, agjencia për muzikën dhe regjistrimet mekanike të saj.

3. Afati i licencës është tre vjet nga hyrja në fuqi e këtij urdhri.

4. Urdhri i ministrit nr.66, datë 30.3.2004 revokohet.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I TURIZMIT, KULTURËS, RINISË
DHE SPORTEVE
Ylli Pango



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE
ZYRA SHOQIPTARE PËR TË DREJTËN E AUTORIT
MINISTRI

LIÇENCË

Nr. 2 Dt 01 / 04 2008

Në mbështetje të ligjit nr 9380, dt 28.04.2005 "Për të Drejtën e Autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të" dhe V.K.M nr. 232, datë 19.04.2006 "Për krijimin dhe funksionimin e Zyrës Shqiptare për të Drejtat e Autorit (ZSHDA)", mbasi konstatoi se dokumentacioni i paraqitur është në përputhje me kërkesat e përcaktuara në kuartrin ligjor në fuqi, Ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve,

VENDOSI:

Të licensojë "FM4A", si Agjenci e Administrimit Kolektiv në fushën e kinematografisë dhe të veprave të tjera të audiovizualit, për të ushtruar dhe mbrojtur të drejtat e autoreve krijues, regjizorë dhe skenaristë. Muzika e kësaj fushe të ushtrohet dhe të mbrohet nga "Albautor", Agjencia për Muzikën dhe Regjistrimet mekanike të saj.

Ky subjekt është i njohur si person juridik me Vendim të Gjykatës së Tiranës, me nr. 600/1, datë 24.12.2007, si person i tatueshëm me numër NIPT K716300428, me seli: Rruga "Samë Frashëri", Pallatet "Agimi", shkalla nr. 19, Apartamenti nr. 338, Tiranë.

Drejtues: **Z. Piro MILKANI**

Licenca është e vlefshme për një periudhë 3 (tre) vjeçare.

Kjo licencë hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Licenca duhet të ekspozohet në zyrat e agjencisë.

